



***Prof. Dr. Eleni Nastas***

Profesor në Departamentin e  
Formimit të Përgjithshëm dhe  
Zhvillimit Profesional

# KONTAKTE

✉ [zv-dekan.mjekesi@umb.edu.al](mailto:zv-dekan.mjekesi@umb.edu.al)



## ***Prof. Dr. Eleni Nastas***

Profesor në Departamentin e  
Formimit të Përgjithshëm dhe  
Zhvillimit Profesional

# ***BIOGRAFIA***

Prof. Dr. Eleni Nastas ka përfunduar studimet në Fakultetin e Mjekësisë, Universiteti i Tiranës, gjatë viteve 1975–1981. Është specializuar në Pediatri të Përgjithshme pranë Institutit të Pediatriisë, Tiranë, gjatë viteve 1981–1983. Në vitin 1992 ka mbrojtur specializimin në Hematologji Pediatrike pranë Shërbimit të Hematologjisë në të njëjtin institut.

Ka ndjekur një specializim tre-mujor në Beilinson Center, Departamenti i Pediatriisë, Klinika e Onko-Hematologjisë, Universiteti Tel-Aviv, Izrael (maj-gusht 1997). Specializimet kanë vijuar në Spitalin Microcitemico, pranë Universitetit të Cagliari, në Sardenjë, Itali (janar-prill 2002), dhe me një kualifikim dy-javor në Klinikën e Onko-Hematologjisë, James University Hospital, Leeds, Angli (tetor 2001).

Në vitin 1996 ka marrë gradën shkencore “Doktor i Shkencave”; në vitin 2007 ka fituar titullin “Profesor i Asociuar” dhe në vitin 2016 titullin “Profesor”.

Nga viti 1981 deri në vitin 1984 ka ushtruar profesionin si mjeke pediatre e përgjithshme në Institutin e Pediatriisë, Tiranë. Më pas, nga viti 1984 deri në vitin 1996, ka punuar si mjeke hematologe në pediatri.